



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 274/10 prot.

Tiranë, më 13.3.2025

V E N D I M

Nr.6, datë 13.3.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE
ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT TË
INSTITUCIONIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR TRANSFERIMIN E
PËRHERSHËM TË NËPUNËSIT IDRIZ HAXHIAJ**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacioneve të dërguara nga nëpunësi civil Idriz Haxhiaj, të regjistruara pranë Komisionerit me nr. 274 prot., datë 27.2.2025; nr. 274/1 prot., datë 3.3.2025; nr. 274/4 prot., datë 5.3.2025, si dhe nr. 274/5 prot., datë 7.3.2025,

VËREJ SE:

Në përmbajtjen e informacioneve të dërguara pranë Komisionerit nga nëpunësi civil Idriz Haxhiaj, pretendohet se janë lejuar parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme, pasi ndaj tij është aplikuar instituti i transferimit të përhershëm në kundërshtim me ligjin.

Sipas akteve të administruara rezulton se punonjësi në fjalë, ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe të Sigurisë Publike”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rending, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme dhe pas ristrukturimit të institucionit, është transferuar

në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe i Jetësimit të Prioriteteve*”, në Ministrinë e Mbrojtjes, me argumentin se kanë ndryshuar kërkesat e posaçme të pozicionit të punës.

Në lidhje me këtë fakt, nëpunësi parashtrohet se ndryshimi i përshkrimit të punës në këtë rast nuk është esencial, pasi nuk ka ndryshuar misioni dhe përgjegjësitë e drejtorisë, por ka ndryshuar vetëm një prej kriterëve të posaçme, që i përket fushës së edukimit arsimor, e konkretisht, tashmë kërkohet edukimi arsimor në fushën e shkencave të sigurisë, ndërkohë që, sipas përshkrimit të mëparshëm të punës, për këtë pozicion kërkohet lloji i diplomës në fushën e shkencave shoqërore.

Nga ana tjetër, nëpunësi pretendon se, për shkak të procesit të ristrukturimit ku do të përfshihet Ministria e Mbrojtjes, pozicioni i punës “*Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe i Jetësimit të Prioriteteve*”, në të cilin ai është transferuar, do të këtë ndryshime, e për këtë arsye është i pamundur transferimi i tij në këtë pozicion pune.

Në këto rrethana, Komisioneri pasi analizoi situatën dhe vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara në administrimin e shërbimit civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, i ndryshuar, ka filluar kryesisht procesin e verifikimit, nëpërmjet shkresës nr. 274/2 prot., datë 3.3.2025, dërguar Ministrisë së Brendshme dhe Departamentit të Administratës Publike, duke kërkuar praktikën e plotë shkresore, ku materializohet procedura e ndjekur në rastin e ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme.

Gjatë shqyrtimit të këtij rasti, Komisioneri ka kërkuar sqarime nga palët e përfshira në këtë proces, ndër të cilat janë Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes dhe ka administruar aktet që kanë dalë prej tyre.

Në përgjigje të kësaj praktike, institucioni i Ministrisë së Brendshme ka dërguar shkresën nr. 274/3 prot., datë 4.3.2025 “*Kthim përgjigje shkresës nr. 274/2 prot., datë 3.3.2025*”, për të cilën ka informuar edhe Departamentin e Administratës Publike, duke arsyetuar veprimet procedurale të ndjekura gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit, shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës provues.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit të administruar për këtë rast, rezulton se janë kryer këto veprime administrative, të materializuara me aktet përkatëse:

- Procesi i ristrukturimit ka nisur me urdhrin nr. 244, datë 27.12.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ministrisë së Brendshme*”, të Kryeministrit, nëpërmjet të cilit është miratuar struktura dhe organika e re, e institucionit të Ministrisë së Brendshme.

Në zbatim të këtij urdhri, si dhe të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.2.2016 *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*; si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të DAP *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucioni”*, institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi, duke ndjekur procedurën e parashikuar në këto akte ligjore dhe nënligjore.

Nga analiza e procesit të ristrukturimit, evidentohen disa prej shkaqeve të cilat e kushtëzojnë atë, sipas parashikimit ligjor, ndër të cilat:

1. Shtimi i numrit të vendeve të punës, *(181 pozicione pune, nga 172 pozicione pune sipas strukturës së mëparshme)*;
2. Ndryshimi i mënyrës së organizimit të disa drejtorive të përgjithshme, përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, *(ndryshimi i emërtesës në Drejtoria e Përgjithshme e Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjet Territoriale, si dhe rritja e numrit të punonjësve nga 20 në 21 punonjës)*.

Në vijim të procesit, në përputhje me kërkesat e pikës 16, të VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016, si dhe pikës II.1, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet shkresës nr. 7570/133 prot., datë 31.12.2024 *“Mbi krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”*, ka kërkuar nga njësia përgjegjëse DAP, nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, duke dërguar edhe emrat e anëtarëve për krijimin e këtij organi, të evidentuar si më poshtë:

- Znj. Suzana Hoxha, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm;
- Z. Ardian Maçi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

Në përgjigje të kësaj kërke, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 21/2 prot., datë 7.1.2025 *“Përcillet urdhri i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”*, ka dërguar pranë institucionit, urdhrin nr. 12, (nr. 21/1 prot.), datë 7.1.2025 *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”*, me këtë përbërje:

- Znj. Migena Braçe, Drejtor i Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Departamentin e Administratës Publike- **Kryetar**;
- Znj. Suzana Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme- **Anëtar**;
- Z. Ardian Maçi, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Brendshme- **Anëtar**.

Konstatohet se, përbërja e Komisionit të Ristrukturimit që ka vepruar në këtë rast në Ministrinë e Brendshme, është në përputhje me kërkesat e pikës 17, të VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016, si dhe pikës II.2.a, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP. Gjithashtu, përbërja e komisionit është në përputhje edhe me parashikimin e pikës II.3, të këtij akti, që përcakton se përfaqësuesi i DAP duhet të jetë në krye të këtij mekanizmi, pasi Kryetar i tij, është caktuar një përfaqësues nga ky institucion.

Në kuadër të këtij procesi restrukturimi, në zbatim të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, parashikimit të pikës 15, të VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016, konstatohet se në datën 31.12.2024, institucioni ka njoftuar me shkresë individualisht të gjithë nëpunësit civil, për fillimin e procesit të restrukturimit.

Ndërkohë, Komisioni i Ristrukturimit ka vijuar procedurën administrative duke marrë në shqyrtim dokumentacionin, si dhe analizuar të dhënat lidhur me procesin, ndër të cilat:

- Strukturën dhe organikën ekzistuese të institucionit të Ministrisë së Brendshme;
- Strukturën dhe organikën e re të institucionit të Ministrisë së Brendshme;
- Administrimin dhe verifikimin e përshkrimeve të punës;
- Verifikimin e të dhënave të nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e restrukturimit, të dokumentuara në dosjet personale të tyre;
- Verifikimin dhe vlerësimin e kriterëve specifikë të vendeve të lira apo të krijuara, të prekura si pasojë e restrukturimit.

Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni i Ristrukturimit, ka rezultuar se, pozicioni i punës “*Drejtor i Politikave të Rendit dhe të Sigurisë Publike*”, është riorganizuar në tërësi duke e argumentuar këtë veprim me arritjen e qëllimit për përmbushjen e detyrimeve me karakter të brendshëm, si dhe në kuadër edhe të proceseve integruese, ku kërkohet rritja e nivelit profesional të kapaciteteve të burimeve njerëzore për pozicionet e rendit dhe sigurisë publike. Ky arsyetim ka qenë edhe motivi për ndryshimin e përshkrimit të punës për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe të Sigurisë Publike*”, i cili rezulton të jetë kryer në përputhje me procedurat e kërkuara, ku kriteri arsimor është përcaktuar të jetë në nivelin Master Shkencor, në Akademinë e Sigurisë.

Pas shqyrtimit të rastit në fjalë, Komisioni i Ristrukturimit ka konstatuar se, nëpunësi Idriz Haxhijaj, nuk plotëson kriterin arsimor të pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe të Sigurisë Publike”, pasi nuk zotëron diplomë në nivelin Master Shkencor, në Akademinë e Sigurisë së Ministrisë së Brendshme.

Pas kësaj, në përputhje me përcaktimet e pikës 17-19, të VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016, si dhe pikës II.9 deri II.17, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP, Komisioni i Ristrukturimit ka marrë në shqyrtim mundësinë e sistemit të nëpunësit në pozicione të tjera

vakante në të njëjtin nivel, por ka konstatuar se, nuk ka pasur pozicione vakante të nivelit të mesëm drejtues në Ministrinë e Brendshme.

Për këtë arsye, me aktin administrativ nr.7570/141, datë 23.1.2025 “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë*”, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur t’i propozojë Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ndër të tjera edhe:

“... *Transferimin e përhershëm të z. Idriz Haxhiq, nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme, kategoria e pagës II-b, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes, klasa e pagës II-1.*”

Në vijim, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në pikën 20 të VKM-së nr. 125, datë 1.3.2016 dhe pikën II.18, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve nga marrja e propozimit të Komisionit, me shkresën nr. 21/4 prot., datë 3.2.2025 “*Mbi transferimin e nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme*”, dërguar Ministrisë së Brendshme, ka vendosur transferimin e përhershëm të z. Idriz Haxhiq, nga pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme, kategoria e pagës II-b, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes, klasa e pagës II-1.

Me qëllim përmbylljen e procesit të transferimit të përhershëm, në zbatim të pikës II.19, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP, nëpërmjet shkresës nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, njësia përgjegjëse ka njoftuar nëpunësin Idriz Haxhiq, për transferimin e përhershëm në pozicionin e ri të punës, duke i njohur atij të drejtën për të dhënë mendimin me shkrim për këtë transferim, pranë DAP, brenda 5 ditëve, në përputhje me pikën 21, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave.

Në vijim të njoftimit të DAP, nëpunësi I. Haxhiq, nëpërmjet shkresës nr. 7570/339 prot., datë 14.2.2025 “*Mbi transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, **ka shprehur dakordësinë e tij për transferimin** në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes, kategoria e pagës II-b.

Në këto rrethana, Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Brendshme, me shkresën nr.7570/400 prot., datë 18.2.2025 *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve administrative dhe financiare”*, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe aktit nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025, të DAP, me të drejtë ka vendosur përfundimin e marrëdhënieve administrative dhe financiare për nëpunësin Idriz Haxhiqaj, pranë këtij institucioni, duke filluar nga data 24.2.2025, për shkak të transferimit të përhershëm të tij në pozicionin e ri të punës, në Ministrinë e Mbrojtjes.

Deri në këtë fazë të procesit, për sa analizuam më sipër, rezulton që çdo veprim në kuadër të ristrukturimit **është kryer në përputhje me kërkesat dhe procedurat** që janë të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil dhe në aktet nënligjore që e rregullojnë institutin e ristrukturimit të institucionit.

Pas përfundimit të procesit të transferimit të përhershëm në Ministrinë e Mbrojtjes, nga ana e Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet shkresës nr. 2194/6 prot., datë 7.3.2025, drejtuar Komisionerit dhe protokolluar pranë këtij institucioni me nr. 274/6 prot., datë 10.3.2025, është dërguar material shtesë, i cili ka lidhje me procesin që u evidentua më sipër.

Nga shqyrtimi i këtyre akteve, rezulton se, Departamenti i Administratës Publike me vendimin nr. 12, datë 4.3.2025 *“Për anulimin e aktit nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025, të Departamentit të Administratës Publike, transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit, të z. Idriz Haxhiqaj”*, ka vendosur të anulojë aktin nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025 *“Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit”* dhe t’i kthejë Komisionit të Ristrukturimit, për rishikim transferimin e z. Idriz Haxhiqaj, në kuadër të ristrukturimit, duke arsyetuar se:

Me shkresën nr. 1206/1 prot., datë 24.2.2025, lënda *“Kërkesë për revokim vendimi transferimi të nëpunësit civil”*, Ministria e Mbrojtjes ka përcjellë pranë DAP, kërkesën për revokimin e aktit nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025 të nxjerrë nga DAP. Në përmbajtje të kësaj shkrese, sqarohet se, Ministria e Mbrojtjes do të përfshihet në proces ristrukturimi ku Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve do të pësojë ndryshime të konsiderueshme në strukturë, të cilat do të reflektohen edhe në përshkrimet e punës (*kriteret e posaçme, detyrat*), që do të rikonceptohen sipas strukturës së re.

E njëjta situatë është e evidentuar edhe në shkresën nr. 21/142, datë 7.3.2025 *“Kthim përgjigje për dokumentacion”*, të dërguar nga Departamenti i Administratës Publike, e cila është protokolluar pranë Komisionerit me nr. 274/8, datë 12.3.2025, ku ndër të tjera Departamenti i Administratës Publike, argumenton se ka marrë parasysh rrethanat e parashtruara nga Ministria e Mbrojtjes dhe bazuar në nenin 15, të ligjit për nëpunësin civil dhe në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative, ka anuluar aktin e mëparshëm për transferimin e përhershëm të punonjësit në fjalë dhe i ka rikthyer Komisionit të Ristrukturimit për rishikim transferimin e tij.

Në vijim të zbatimit të vendimit nr. 12, datë 4.3.2025, të Departamentit të Administratës Publike për anulimin e aktit nr. 21/81 prot., datë 3.2.2025, Komisioni i Ristrukturimit, është mbledhur për të rishqyrtuar dhe vlerësuar edhe një herë mundësinë e sistemimit të nëpunësit Idriz Haxhiaj. Për këtë qëllim, ka kërkuar informacion nga DAP mbi vakancat aktuale, referuar planit vjetor të pranimi në shërbimin civil të miratuar me VKM-në nr. 16, datë 9.1.2025, si dhe përshkrimet e punës për të verifikuar kriteret e posaçme për pozicionet vakante.

Nga informacioni i marrë për këtë rast, ka rezultuar vakant pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Ujrave dhe Digave*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me këto kriteret të posaçme:

- Zotërimi i një diplome të nivelit “*Master i Shkencave/Master Profesional me 120 kredite dhe dy (2) vite akademike/ të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë*”, në Shkenca Bujqësore/ Shkenca Ekonomike/ Shkenca Inxhinerike/ Shkenca Juridike. Edhe diploma Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.
- Zotërimi i përvojës së punës në profesion jo më pak se 5 vjet.

Komisioni i Ristrukturimit pasi shqyrtoi të dhënat e dosjes personale të nëpunësit Idriz Haxhiaj, konstatoi se ai zotëron diplomë Master i Shkencave, në Shkenca Juridike dhe mbi 5 vite përvojë në profesion.

Bazuar në përshkrimin e punës të pozicionit vakant “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Ujrave dhe Digave*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kriteret e posaçme, si dhe në dosjen personale të nëpunësit civil I. Haxhiaj, Komisioni i Ristrukturimit me aktin administrativ nr. 2194/5 prot., datë 6.3.2025, ka vendosur:

“Transferimin e përhershëm të z. Idriz Haxhiaj, nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Politikave, Rendit dhe Sigurisë Publike”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin, Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme, kategoria e pagës II- b, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Ujrave dhe Digave”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, klasa e pagës II-1”.

Në këto rrethana, ky vendim është dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike, mbi bazën e të cilit ka dalë akti nr. 21/141 prot, datë 7.3.2025, i DAP, **në përputhje me kompetencat e tij ligjore**, për transferimin e përhershëm të punonjësit Idriz Haxhiaj, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Aktualisht, procesi ndodhet në fazën e marrjes së pëlqimit të punonjësit të transferuar, për të vijuar më tej me veprimet e tjera administrative që e shoqërojnë atë.

Sjellim në vëmendjen e njësisë përgjegjëse se, në këtë fazë të procesit, nëse nëpunësi e pranon propozimin, atëherë vijon marrëdhënia e punës në shërbimin civil në pozicionin përkatës, ndërkohë që, në rast të refuzimit të pozicionit nga nëpunësi i transferuar, njësia përgjegjëse duhet ti referohet pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Nëpunësi mund ta refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në pikën 3, të nenit 48 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirim nga shërbimi civil”*. Në këtë rast, procesi i lirim nga shërbimi civil duhet ti referohet nenit 66, të ligjit për nëpunësin civil.

Për të gjitha sa u analizuan më sipër, referuar dokumentacionit të administruar gjatë verifikimit të rastit, në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe veprimeve administrative të ndërmarra në kuadër të tij, nga Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse DAP, deri në këtë fazë të tij, Komisioneri vlerëson se, këto organe kanë vepruar në respektim të kërkesave të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, që janë Vendimi nr. 125, datë 17.2.2016 i Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, si dhe udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucioni”*, të cilat rregullojnë në tërësi institutin e transferimit të përhershëm në shërbimin civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 e 25 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacioneve të regjistruara pranë Komisionerit me nr. 274 prot., datë 27.2.2025; nr. 274/1 prot., datë 3.3.2025; nr. 274/4 prot., datë 5.3.2025, si dhe nr. 274/5 prot., datë 7.3.2025, të paraqitura nga nëpunësi Idriz Haxhiaj, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura gjatë transferimit të përhershëm të tij, në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme, të finalizuar me aktin nr. 21/141 prot., datë 7.3.2025, të njësisë përgjegjëse, DAP, në kushtet kur në veprimet e kryera nga organi kompetent Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse DAP, nuk konstatohen elementë që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi Idriz Haxhiqj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha